



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr./Br. 609/18  
Date/Datum 04.12.18  
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 609/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "VE-MOR" Shpk – Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Toifor Sh.p.k"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës – Lot II", me nr. të prokurimit: 616-18-421-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë, më datë: 30.11.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "VE-MOR" Shpk – Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës –Lot II", me nr. të prokurimit: 616-18-421-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë.

II. ANULOHET, të tersi aktiviteti i prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës –Lot II", me nr. të prokurimit: 616-18-421-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK – Prishtinë dhe nëse edhe me tutje AK-ja ka interes për ta zhvilluar ketë aktiviteti të prokurimit të njëjtin mund ta Ritenderoi konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "VE-MOR" Shpk – Pejë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 02.04.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 23.04.2018, ku kanë marrë pjesë tetë (8) operator ekonomik.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e Pasuksesshëm 12.10.2018

Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së 12.08.2018

Data e kërkesës për rishqyrtim 17.10.2018

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim 19.10.2018

Operatori ekonomik ankues "VE-MOR" Shpk – Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.10.2018, me nr. 609/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës – Lot II", me nr. të prokurimit: 616-18-421-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë, duke pretenduar se:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 52, 56, 59, 60, 61, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe 18.5 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik;

Organit Shqyrtares i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.10.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtares, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtares përmes raportit te dt: 05.11.2018, ka konstatuar si në vijim:

Lidhur me pretendimin parë (1) të operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 1, 6, 7, 56, 59 par. 4, 60 par. 1 nen parg. 1.1, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe nenin 4.4 dhe 18.5 te RrUOPP.

Eksperti shqyrtares sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtares të Prokurimit, nen 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët ne procedurë

lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara “res judikata”, sipas nenit 105.2.16 te LPP-së, si dhe janë svaruar nga dy (2) vendimet e OSHP të nxjerrura për ketë aktivitet te prokurimit.

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues svaron si në vijim: Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo te konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkova në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57.

Lidhur me pretendimin e dytë (2) të operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 20 te FDT-se, pika: 20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€), dhe duhet te përfshinë te gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës.

Eksperti shqyrtues svaron lidhur me këtë pretendim te OE ankues qëndron bazuar ne nen 59 par.4 te LPP-së po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim lidhje me pretendimin ankimore te OE ankues, eksperti shqyrtues svaron se AK – Komuna e Prishtinës, këtë pretendim gjate vlerësimit e ka trajtuar si devijim i vogël pasi nuk ka qene pretendim ankimore nga OE ankues ne dy (2) ankesat e parashtruara nga ky OE. Megjithatë, edhe devijimet më të vogla në shumicën e rasteve do te konsiderohen materiale, varet nga ajo se çfarë janë “aspektet materiale”, pra me fjalë tjera çdo aspekt do te konsiderohet si material, prandaj bazuar nga këto qe potencova me larte konsideroj se tek Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE, OE i rekomanduar për kontrate ka shtuar edhe ne rresht ne Excel “Totali me TVSH” duke përshkruar edhe çmimin njësi edhe pse AK nuk e ka kërkuar çmimin njësi në tabelën e

përshkrimit te çmime ne Excel dhe pasi nuk ka ndërhyrje tek përshkrimi i artikullit apo tek sasia, atëherë mund te trajtohet si një devijim i vogël dhe mund te merret si gabim teknik apo lëshim nga operatori ekonomik (*pasi që nuk është sqaruar nga autoriteti kontraktues si të plotësohet apo të veprohet me plotësimin e kësaj liste pasi ka munguar çmimi njësi, edhe pse OE i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmimet poz. nr.3 = 0.008 dhe poz. nr.4= 0.005*), prandaj në bazë të sqarimeve te mësipërme vlerësojë se pretendimet e palës ne ankesa ne këtë pike janë pjesërisht të qëndrueshme,pasi konsideroj se AK ka vepruar në pajtim me nenit 59.4 te LPP-së lidhur me ketë pretendim te OE ankues.

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, rekomandojmë që ankesa e OE: "VE-MOR" Shpk – Pejë, për tenderin e AK – "KK – Prishtinë", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Prishtinës –Lot II", me nr. të prokurimit: 616-18-421-2-1-1, të aprovojen si pjesërisht të bazuara(për arsyen që u cek tek përgjigjet në pretendimet më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë Autoritetin Kontraktues, dhe të njëjtin tender rekomandojmë Autoritetin Kontraktues, që të mbetet në fuqi vendimi i AK, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 30.11.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues-profesional i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e konratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Asllani deklaroj: Ne nuk pajtohem me vendimin AK dhe mendimin e ekspertit për lëndën 609/18 për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit-pjesa 2" me nr.prok:616/18/421/211. Arsyen lidhur me pretendimin 1 nuk pajtohem se OE Toifor se ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se mund të kryej këto punë sepse ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët ku janë plotësuar gjitha rregullat sipas rregullave për çmim jo normalisht të ulët.

Pretendimi 2, lidhur me valutat dhe kalkulimin e çmimit sipas dosjes së tenderit pika 20.1, ku sipas kësaj pike gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në euro dhe duhet të përfshihen gjitha takasakt e aplikueshme detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi ofertuar lejohet të shënohet me maksimum dy numra pas presjes dhjetor, çdo numër pas numrit të dytë nuk do merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Gjatë qasjes në dokumente të OE Toifor me 17.10.2018 kemi siguruar dëshmi shtesë se OE është i

pa përgjegjshëm siç janë në vijim, OE fitues Toifor sipas kësaj pike në pozicionin 3 ka ofruar çmim prej 0.008, çdo numër pas numrit te dytë nuk do merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.

Në pozicionin 4 ka ofruar çmim 0.005, (çdo numër pas numrit dytë nuk do merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës). Pra OE është i papërgjegjshëm për shkak se ka aplikuar në kundërshtim me nenin 20.1 të FDT. Pra OE Toifor po ashtu ka bërë ndërhyrje në paramasë dhe parallogarit duke shtuar një kolonë shtesë pas çmimit me TVSH, dhe ka shënuar në emërimin total me TVSH, që ka bërë ndërhyrje në paramasë dhe parallogarit dhe kjo shpie deri te gabimi i plotësimit të çmimeve me 0.008 dhe 0.005, ku edhe do duhej të shpaljej i papërgjegjshëm nga AK sepse është shkel nen 20.1 i FDT. Si dëshmi se OE është i papërgjegjshëm është vendimi i panelit nr.333/17 ku shkruan “po ashtu paneli konstatoi se dy ofertuesit e këtij aktiviteti kanë ofruar çmime në pozicione të caktuara në kundërshtim me pikën 20 të dosjes- valuta dhe kalkulimi i çmimit ku precizohet se çmimi ofruar lejohet të shënohet me maksimum dy numra pas presjes dhjetore Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë nuk do merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Pra dy OE-të kanë ofruar çmime në pozicione të ndryshme me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. PO ashtu përmes vendimit të panelit me nr.446/16 të datës 25.01.2017 dhe vendimit nr.94/17 të datës 26.02.2017 OE EkoHigjiena është deklaruar i papërgjegjshëm, ku citoj “paneli shqyrtues vjen në përfundim se në këtë aktivitet ka ofertues të papërgjegjshëm prandaj ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në tërësi”. Pra pretendimi se OE është i pa përgjegjshëm e vërteton edhe ky vendim i panelit shqyrtues.

Andaj kërkojmë nga OSHP të aprovoj ankesën tonë dhe të anuloj vendimin eKK Prishtinë dhe të kthej lëndën në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Mekolli deklaroj: Mendoj se nuk ka mbet shumë të flasim për këtë procedurë pasi jemi dëgjuar edhe në herët tjera. AK duke u mbështetur në vendimin 412/18 të datës 19.09.2018 ku AK obligohet që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë lidhur me çmimet e ofruara të OE të rekomanduar për kontratë. AK KK Prishtinë ka kërkuar sqarime shtesë nga OE I rekomanduar për kontratë me cilin rast OE ka ofruar sqarimet e tij, sqarime këto që janë bindëse për AK-në. AK ka respektuar gjitha dispozitat e LPP 04L-042 duke u bazuar në nenin 1 qëllimi i LPP që thotë “qëllimi këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase dhe më transparent të fondeve publike”, si dhe nen 6 që thotë se gjitha AK janë obliguar që thotë fonde publike duhet të përdoren në mënyrën me ekonomike. Andaj komisioni prapë ka vendosur të propozoj për kontratë të njëjtin OE. AK kërkon nga paneli të aprovoj vendimin e AK-së për dhënie të kontratës.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z.Beqiri deklaroj: Sa i përket çmimit jo normalisht të ulët, është plotësuar kriteri sipas rregullores, dhe është kompetence të AK-së sa i përket çmimit. OE e ka shtuar kolonën me çmimin me TVSH me qenë se nuk është kërkuar në formular.

Do thotë kolona çmimi me TVSH nuk ka ekzistuar. Me që nuk ka pas ndërhyrje në përshkrim dhe sasi kam konsideruar kjo të jetë devijim i vogël, me gjithë atë i mbetet panelit të vendos lidhur me këtë çështje.

Në seancë pranë panelit u prezantua lista e çmimeve të OE ankues dhe OE fitues, ku paneli konstatoi se në listën e çmimeve të OE të rekomanduar për kontratë ekzistojnë 3 kolona, ku njëra është për sasi, kolona dytë çmime dhe totali me TVSH, ku në kolonën 2 çmime me TVSH secili çmim i dhënë nga OE i rekomanduar për kontratë pas presjes dhjetore janë edhe nga tre numra tjerë.

Ndërsa te lista çmimeve të OE ankues, janë dy kolona, njëra kolonë sasia, tjetra është çmimi me TVSH.

Paneli shqyrtues konstatoi se pas shikimit të dosjes origjinale në E Prokurim, AK në listën e çmimeve ka vendos vetëm dy kolona, sasinë dhe çmimi me TVSH, pa e përcaktuar se ky çmim me TVSH a është çmim për njësi apo total i çmimit.

Paneli shqyrtues sqaron se kemi të bëjmë me lëndë të përsëritur pasi që më parë janë nxjerr dy vendime nga ana e panelit shqyrtues, Vendimi me Nr. 223/18 me datë 20.06.2018 dhe Vendimi i OSHP Nr. 412/18 me datë 19.09.2018.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, konstatimeve analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe shoshitjes së provave në tërësi në shqyrtim kryesor, konstatoi se në seancë për shqyrtim kryesor pranë panelit u prezantua lista e çmimeve të OE ankues dhe OE fitues, ku paneli konstatoi se në listën e çmimeve të OE të rekomanduar për kontratë ekzistojnë 3 kolona, ku njëra është për sasi, kolona dytë çmime dhe totali me TVSH, ku në kolonën 2 çmime me TVSH secili çmim i dhënë nga OE i rekomanduar për kontratë pas presjes dhjetore janë edhe nga tre numra tjerë. Ndërsa te lista çmimeve të OE ankues, janë dy kolona, njëra kolonë sasia, tjetra është çmimi me TVSH.

Paneli shqyrtues konstatoi se pas shikimit të dosjes origjinale në E Prokurim, AK në listën e çmimeve ka vendos vetëm dy kolona, sasinë dhe çmimi me TVSH, pa e përcaktuar se ky çmim me TVSH a është çmim për njësi apo total i çmimit. Paneli shqyrtues konstatoi se OE i rekomanduare për kontrate ka shtuar edhe një kolonë tek lista e çmimeve, duke bërë kështu një ndërhyrje në dosjen e tenderit te autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues konstaton se asnjeri nga operatoret ekonomik nuk ka dhënë çmim për njësi lidhur me ketë aktivitet të prokurimit, andaj duke u nisur nga sqarimet dhe faktet e prezantuara si më lart paneli shqyrtues konstaton se aktiviteti i prokurimit në fjalë duhet të anulohet në pajtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44 paragrafi 7 pika ii të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP).

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK - Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE - "VE-MOR" Shpk – Pejë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.